



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË  
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**SHPLLJE PËR LËVIZJEN PARALELE  
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE  
(Specialist për Zbatimin e Projekteve, në Këshillin e Qarkut Vlorë)**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM Nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Vlorë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin :

“Specialist për Zbatimin e Projekteve”, Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Koordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmi/ Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social, në Këshillin e Qarkut Vlorë, kategoria IV, klasa IV-2

Lloji i diplomës “Shkenca Juridike/Ekonomike”, niveli i diplomës “Master Profesional”

**Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil!**

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**Për të dy procedurat lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për  
**LËVIZJE PARALELE:**

**12 SHKURT 2025**

Afati për dorëzimin e dokumentave për  
**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:**

**17 SHKURT 2025**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:**

Specialisti për Zbatimin e Projekteve ka për detyrë dhe është përgjegjës për:

**1.Hartimi i Projekteve:**

**Adresa:** Këshilli i Qarkut Vlorë  
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë  
Vlorë (AL), 9401

**Website:** [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
**E-mail:** [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
**Tel:** +355 33 421 601



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

1.1 Përgatitja e propozimeve për projektet zhvillimore të financuara nga donator të huaj dhe kombëtarë.

1.2 Kryerja e analizave të thelluara për identifikimin e nevojave të rajonit dhe përgatitja e studimeve të fizibilitetit.

1.3 Sigurimi që projektet të jenë në përputhje me objektivat strategjike të Këshillit të Qarkut Vlorë dhe standardet e financuesve.

**2. Koordinimi dhe menaxhimi i projekteve;**

2.1 Menaxhimi i procesit të zbatimit të projekteve, përfshirë, buxhetimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve duke ndjekur parimet e PRAG, që nga faza e nisjes deri në mbyllje, përfshirë përgatitjen e dokumenteve të prokurimit, zbatimin e aktiviteteve dhe raportimin për progresin.

2.2 Bashkëpunimi me stafin për të siguruar alokimin efektiv të burimeve.

2.3 Organizimi i takimeve me partnerët, donatorët dhe aktorët e interesuar për të siguruar bashkëpunim të suksesshëm në të gjitha fazat e projekteve.

**3. Mbikëqyrja dhe raportimi;**

3.1 Monitorimi i përparimit të projekteve dhe hartimi i raporteve periodike për ecurinë e tyre.

3.2 Përgatitja e raporteve për donatorët dhe institucionet vendase mbi arritjet dhe sfidat e projekteve.

3.3 Sigurimi që projektet të respektojnë afatet kohore dhe buxhetin e caktuar.

**4. Bashkëpunimi me donatorët dhe partnerët;**

4.1 Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me organizatat financuese e partnerë vendor e ndërkombëtarë.

4.2 Pjesëmarrja në aktivitete promovuese dhe trajnime për përmirësimin e kapaciteteve të institucionit për thithjen e fondeve dhe për zbatimin e projekteve me standarde të larta.

**5. Pjesëmarrja në politikat sociale dhe turizëm;**

5.1 Sigurimi që projektet të mbështesin zhvillimin e politikave sociale dhe promovimin e turizmit në rajon.

5.2 Zhvillimi i projekteve inovative për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve sociale dhe për të rritur atraktivitetin turistik të rajonit të Vlorës.

6. Hartimi i kontratave dhe ndjekja e zbatimit të tyre.

7. Ndjekja e marrëveshjeve të partneritetit/kontratave me partnerët e huaj.

8. Orientimi i stafeve të projekteve me procedurat ligjore dhe detyrimet ligjore që lidhen me zbatimin e projekteve.

9. Mbajtja e dosjeve elektronike, manualeve të procedurave ligjore, prokurimeve me PRAG-un dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me zbatimin e projekteve.

10. Përgjigjet, mbështet dhe vendos në dispozicion të auditeve, kontrolleve dhe çdo strukture monitorimi përgjegjëse për zbatimin e projekteve dokumentacionin e nevojshëm.

11. Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga ligji, Kryetari dhe Eprori direkt .

**1 LËVIZJA PARALELE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:**

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon, kategoria IV, klasa IV-2;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal “Master Profesional” në “Shkenca Juridike/Ekonomike”. *(Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të kenë të paktën mbi 1 (një) vit përvojë pune në profesion në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.
- c- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d - Të zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze.

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b – Kopje të diplomës (përfshirë diplomën Bachelor) e noterizuar. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- c – Kopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, Zyra e Burimeve Njerëzore brenda datës **12.02.2025**, në adresë: Këshilli Qarkut Vlorë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Pallati i Kulturës “Labëria”, Kati i III –të , Vlorë*

### **1.3** REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14.02.2025**, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Vlorë, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Vlorë, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### **1.4** FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligjin Nr. 9367 dt. 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar .
- Njohuri mbi Practical Guide/PRAG për procedurat e prokurimit për veprimet e jashtme të BE - së.

### **1.5** MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
- b) 60 pikë intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

**1.6**

**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Vlorë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

**2**

**PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë.

**2.1**

**KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

**Adresa:** Këshilli i Qarkut Vlorë  
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë  
Vlorë (AL), 9401

**Website:** [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
**E-mail:** [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
**Tel:** +355 33 421 601



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal “Master Profesional” në “Shkenca Juridike/Ekonomike”. *(Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b-Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- c - Të zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Kopje të diplomës (përfshirë diplomën Bachelor) e noterizuar. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- c - Kopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, Zyra e Burimeve Njerëzore brenda datës **17.02.2025** në adresë: Këshilli Qarkut Vlorë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Pallati i Kulturës “Labëria”, Kati i III –të, Vlorë.**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **25.02.2025**, Njësi e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli Qarkut Vlorë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

**2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligjin Nr. 9367 dt. 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar .
- Njohuri mbi Practical Guide/PRAG për procedurat e prokurimit për veprimet e jashtme të BE - së.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- deri në **15 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar.
- b- deri në **60 pikë** për vlerësimin me shkrim.
- c- deri në **25 pikë** për Intervistën e strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

**2.6**

**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli Qarkut Vlorë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë duke filluar nga data **14.02.2025**.